

VISAR KUÇI është një ndër violinistët më të dalluar të gjeneratës së re në Kosovë. Ai është poliinstrumentist (luan në violinë, kontrabas, kitarë, bas-kitarë, violë dhe piano). U lind më 1983 në Prishtinë. Ka përfunduar shkollimin e ulët dhe atë të mesëm në klasën e prof. Sihana Badivukut në shkollën e muzikës “Prek Jakova” në vendlindje. Më 2006 diplomoi në Fakultetin e Artit Muzikor të Universitetit “Westfälischen Wilhelms” në Mynster të Gjermanisë. Në tetor të vitit 2008 Kuçi u zgjodh asistent i Prof. Sihana Badivukut në Fakultetin e Arteve. Ai është Koncertmjeshtër i Filarmonisë së Kosovës.

Deri më tash ka mbajtur koncerte të ndryshme si solist dhe anëtar ansamblesh në Gjermani, Itali, Austri, Belgjikë, Holandë, Bosnjë e Hercegovinë si dhe në Kosovë. Ka qenë pjesëmarrës në festivale, si: “Nah Klang” 2002, “Musik Unserer Zeit” 2004, “Klangzeit” 2005, “Münsterlandfestival” 2006 në Gjermani, “ReMusica” 2007 si dhe në 5 edicione të festivalit DAM në Prishtinë. Ai ka ndjekur punëtori të udhëhequra nga: Maxim Vengerov, Tedi Papavrami, Pavel Vernikov, Sergey Kravtchenko, Alexandre Vinnitski, Eugenia Tchugaewa, Peter Sheppard Skaerved dhe Alexandre Dubach. Ai ka bashkëpunim të ngushtë me pianistin Clemens Rave dhe fis-harmonistin Piotr Ragno në Gjermani.